

LIGJI NR. 08/L-131**PËR SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të Nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR SHËRBIMIN KORREKTUES TË KOSOVËS**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i statusit, parimet, përgjegjësitë, menaxhimi dhe organizimi përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim, të drejtat ose detyrimet specifike, rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave, zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime, transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet për të gjithë të punësuarit në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

**Neni 3
Përkufizimet dhe shkurtesat**

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **AKSP** - Akademia e Kosovës për Siguri Publike;
- 1.2. **Drejtori i Përgjithshëm** - Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së;
- 1.3. **Drejtoria e Përgjithshme**- strukturë organizative e SHKK-së e nivelit qendror;
- 1.4. **I burgosur** - të gjithë personat e privuar nga liria të cilët gjenden në Institucionet Korrektuese;
- 1.5. **I dënuar**- personi dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm;
- 1.6. **I mitur**- personi sipas përkufizimit në Kodin e Drejtësisë për të Mitur;
- 1.7. **I paraburgosur**- personi të cilit i është shqiptuar masa e paraburgimit;
- 1.8. **IAP** - Institucioni i Avokatit të Popullit - Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës;
- 1.9. **IK** - Qendrat e Paraburgimit dhe Qendrat Korrektuese dhe Burgu i Sigurisë së Lartë;

- 1.10. **LESP**- Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- 1.11. **Ministria** - Ministria e Drejtësisë;
- 1.12. **NJPB**- Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve;
- 1.13. **OJQ** - organizata joqeveritare monitoruese;
- 1.14. **Personeli i SHKK-së** - të gjitha kategoritë e të punësuarve në SHKK;
- 1.15. **SHKK**- Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- 1.16. **ZKF**- Zyrtari Kryesor Financiar;
- 1.17. **Zyrtar Korrektues** - personeli i uniformuar dhe i graduar.

Neni 4 Parimet

1. Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës ushtrojnë detyrën në bazë të parimeve të:

- 1.1. ligjshmërisë - Personeli i SHKK-së ushtrojnë të gjitha detyrat në bazë të Kushtetutës, instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare si dhe legjislacionit në fuqi;
- 1.2. përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit - Personeli i SHKK-së zbaton parimet e përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit si një kufizim në ushtrimin e detyrave dhe autorizimeve. Autorizimet ushtrohen vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që nevojitet për t'i arritur objektivat ligjore të SHKK-së dhe me pasojat sa më pak të dëmshme dhe për kohë sa më të shkurtër të mundshme;
- 1.3. detyrimit për t'iu përgjigjur kërkesave dhe ankesave - Personeli i SHKK-së duhet të përgjigjen ndaj kërkesave, ankesave të dorëzuara nga të burgosurit, individët ose organe të tjera;
- 1.4. efektshmërisë dhe efikasitetit - Personeli i SHKK-së duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve, rregullave dhe procedurave administrative dhe të sigurisë për përmbushjen e objektivave të SHKK-së;
- 1.5. përgjegjësisë - Personeli i SHKK-së është i detyruar që të raportojë, shpjegojë dhe të përgjigjet për pasojat e vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve të tyre;
- 1.6. paanësisë dhe pavarësisë profesionale - Personelit të SHKK-së nuk i lejohet njëanshmëria, që do të thotë të ketë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një situatë, duke shkaktuar si rrjedhojë një dëm të pajustificueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtën e palëve të tjera të interesuara;
- 1.7. transparencës – Shërbimi Korrektues i Kosovës është i hapur për publikun;
- 1.8. konfidencialitetit - personeli i SHKK-së ruan konfidencialitetin e informacionit që kanë në zotërim por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që dalin nga legjislacioni që ka të bëjë me qasjen në dokumente publike, ose nuk japin informata të cilat mund të rrezikojnë punën e Institucionit apo të SHKK-së, të personave të privuar nga liria apo personelin e SHKK-së;
- 1.9. shmangies së konfliktit të interesit - Personeli i SHKK-së duhet të mos lejojë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë

konflikt interesi. Personeli i SHKK-së vepron në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;

1.10. parimit të mundësive të barabarta - Personeli i SHKK-së ka mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës;

1.11. parimit të respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut - Personeli i SHKK-së është i obliguar të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;

1.12. parimit të mos-diskriminimit - Nuk lejohet kurrfarë diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual. Përjashtimisht kriterëve të moshës dhe sigurimit të kuotës gjinore për punësim, për shkak të specifikave dhe natyrës së punës për zyrtarë korrektues nuk konsiderohet diskriminim;

1.13. llogaridhënies - zyrtarët publik të SHKK-së obligohen që të japin llogari lidhur me ushtrimin e autorizimeve të tyre krahas ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të punës në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

KAPITULLI II STATUSI VEPRIMTARIA DHE PËRGJEGJËSITË E SHKK-së

Neni 5 Statusi i Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. SHKK është Agjenci ekzekutive e sigurisë cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. SHKK ka shenjën identifikuese, uniformën, flamurin dhe emblemën të cilat miratohen nga Ministri pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së.

Neni 6 Pavarësia e SHKK-së

1. SHKK është e pavarur në kryerjen e funksionit të vet në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.
2. Asnjë organ ose institucion publik nuk ka të drejtë që në çfarëdo mënyre të ndikojë në pavarësinë funksionale të SHKK-së.

Neni 7 Udhëheqja e SHKK-së

Me punën e SHKK-së udhëheq Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet në bazë të konkursit publik sipas procedurës të legjislacionit në fuqi për emërimin në pozitat e kategorisë së lartë drejtuese.

Neni 8 Veprimtaria e Shërbimit Korrektues

1. SHKK është përgjegjëse për:
 - 1.1. organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 1.2. organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese në IK përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe;

- 1.3. zbatimin e masës së paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale;
- 1.4. ndërmarrjen e masave të sigurisë për të ofruar ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për jetë dhe punë;
- 1.5. ndërmarrjen veprimeve për ruajtjen e rendit, disiplinës dhe mbrojtjes së pronës në institucionet korrektuese të SHKK-së;
- 1.6. vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për trajtimin e të burgosurve;
- 1.7. planifikimin, organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programeve që i kontribuojnë risocializimit të burgosurve;
- 1.8. nxitjen, motivimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive punuese për të burgosur;
- 1.9. zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njësive ekonomike të SHKK-së;
- 1.10. motivimin dhe krijimin e mundësive për arsimim dhe aftësim profesional për të burgosurit;
- 1.11. zhvillimin profesional të personelit të SHKK-së;
- 1.12. realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse dhe organizatat të cilat merren me çështjen e monitorimit e të drejtave të të burgosurve;
- 1.13. udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar lidhur me planin e riintegritimit pas lirimit;
- 1.14. përmbushjen e obligimeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Buxheti dhe menaxhimi financiar

1. SHKK ka buxhetin e vet të ndarë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
2. ZKF përgatit buxhetin e SHKK-së dhe ia përcjellë drejtorit të përgjithshëm për miratim. Pas miratimit, drejtori i përgjithshëm ia përcjellë ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm.
3. Buxheti duhet të mbulojë koston e plotë të funksionimit të SHKK-së dhe institucioneve korrektuese për garantimin e menaxhimit të vazhdueshëm sipas standardeve përkatëse.

Neni 10

Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. SHKK përbëhet nga:
 - 1.1. Drejtoria e Përgjithshme e nivelit qendror që funksionon me departamente dhe divizione si dhe;
 - 1.2. Institucionet korrektuese.
2. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i Shërbimit Korrektues të Kosovës, rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 11 **Drejtoria e Përgjithshme**

1. Drejtoria e Përgjithshme e SHKK-së autorizohet të:

- 1.1. mbikëqyrë ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësive organizative të institucioneve korrektuese përmes mekanizmave të saj;
- 1.2. hartojë projekt akte nënligjore, rregulla dhe procedura standarde veprimi nga fushë-veprimtaria e SHKK-së;
- 1.3. menaxhojë, vëzhgojë, analizojë dhe vlerësojë situatën e tërësishme operative dhe të sigurisë në kuadër të SHKK-së;
- 1.4. bëjë vlerësimin dhe klasifikojë rrezikshmërinë e të burgosurve;
- 1.5. mbikëqyrë trajtimin e të burgosurve në IK;
- 1.6. mbledhë dhe përpunojë informacione të cilat mund të paraqesin rrezik për institucionet e SHKK-së;
- 1.7. udhëheqë veprimet në kuadër të SHKK-së në rrethana të jashtëzakonshme ose urgjente;
- 1.8. koordinojë zhvillimin dhe implementimin e politikave strategjike shtetërore për të përmbushur obligimet dhe misionin e SHKK-së;
- 1.9. kujdeset për sigurimin e kushteve të punës, shëndetit dhe sigurisë për personelin;
- 1.10. koordinojë funksionet administrative të SHKK-së, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikimin e personelit, trajnimin dhe aftësimin e personelit të SHKK-së në mirëmbajtjen e të dhënave, sistemin e telekomunikimit, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin, inxhinieringun dhe logjistikën;
- 1.11. bashkëpunojë me institucionet shtetërore, agjencitë e zbatimit të ligjit, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, kulturore, fetare dhe akterët e tjerë relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë;
- 1.12. kryejë hetimet e brendshme administrative dhe koordinon punën e komisioneve përkatëse në nivel të SHKK-së;
- 1.13. kryejë punë të tjera të parapara me ligj, akte nënligjore apo urdhra.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.

Neni 12 **Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm në kuadër të funksioneve të tij ka këto përgjegjësi:

- 1.1. udhëheqë dhe përfaqëson SHKK-në;
- 1.2. planifikon, zhvillon, administron dhe menaxhon SHKK-në dhe është përgjegjës për garantimin e zbatimit të funksioneve që janë përcaktuar me legjislacionin në fuqi;

- 1.3. zbaton obligimet që rrjedhin nga Politikat Strategjike Shtetërore të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- 1.4. mbikëqyrë sigurinë në institucionet korrektuese për të garantuar ambient të sigurt për të burgosur dhe personelin e SHKK-së;
- 1.5. planifikon dhe ekzekuton buxhetin dhe miratimin e pagesave sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.6. zbaton politika jo diskriminuese për personelin e SHKK-së duke përfshirë edhe përfaqësimin e barabartë në të gjitha fushat dhe nivelet;
- 1.7. kordinon hartimin e politikave të SHKK-së;
- 1.8. mbikëqyrë ligjshmërinë e punës dhe të veprimit të njësive organizative të SHKK-së;
- 1.9. ushtron përgjegjësitë e përcaktuara me LESP lidhur me trajtimin e të burgosurve;
- 1.10. nxjerrë vendime, rregulla dhe procedura të brendshme për SHKK-në, të parapara me legjislacionin në fuqi;
- 1.11. jep urdhra operativ për vartësit e tij;
- 1.12. autorizon komisione hetuese të brendshme për zbatim të hetimeve administrative në kuadër të SHKK-së;
- 1.13. themelon komisione të përkohshme për çështje pune dhe autorizon përfaqësues për pjesëmarrje në grupe punuese, komisione dhe punëtori jashtë SHKK-së;
- 1.14. lidhë marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata në emër të SHKK-së me institucionet shtetërore dhe organizatat qeveritare dhe joqeveritare;
- 1.15. kryen edhe detyra të tjera të përcaktuar me legjislacionin në fuqi;
- 1.16. Drejtori i Përgjithshëm për performancën dhe veprimtarinë e SHKK-së i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë.

Neni 13

Përzgjedhja dhe Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm

1. Kërkesat e përgjithshme për pranimin në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm janë:
 - 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
 - 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
 - 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas ligjit për Zyrarët Publik.
2. Përveç kushteve që parashikohen në paragrafin 1. të këtij neni, kandidatët për t'u pranuar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm duhet t'i plotësojnë edhe kriteret e veçanta si:

2.1. të ketë përgatitje universitare;

2.2. të ketë së paku tetë (8) vite përvojë pune në Shërbimin Korrektues ose në institucionet e sigurisë prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë në pozitë të larta apo të mesme drejtuese.

3. Drejtori i Përgjithshëm emërohet për një mandat katër (4) vjeçar me të drejtë rizgjatje për të njëjtën pozitë edhe për një mandat.

4. Drejtori i Përgjithshëm emërohet në detyrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Për qëllim të këtij neni institucionet e sigurisë janë: Policia e Kosovës, Inspektorati Policor, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe Dogana e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Neni 14

Përfundimi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm, lirohet, shkarkohet, apo i përfundon mandati kur:

1.1. është dënua për veprë penale me vendim të formës së prerë sipas legjislacionit në fuqi;

1.2. arrin moshën për pension;

1.3. jep dorëheqje;

1.4. ka munguar në ushtrimin e detyrës për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj;

1.5. me mbarimin e mandatit;

1.6. për shkak të përfomancës jo të mirë të dokumentuar.

2. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i ShKK-së ka kryer veprë penale, Ministri njofton organet kompetente dhe ndërmerr veprimet e përcaktuara ndaj tij sipas legjislacionit përkatës në fuqi dhe për të njëjtat e njofton Qeverinë.

3. Në rastet e lirit, shkarkimit apo suspendimit të Drejtorit të Përgjithshëm, Ministri menjëherë cakton përkohësisht njërin nga Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm zëvendësues të Drejtorit të Përgjithshëm.

4. Me përfundimin e mandatit për Drejtor të Përgjithshëm, njësia përgjegjëse detyrohet të emërojë nëpunësin të cilin i mbaron mandati në një pozitë të mesme drejtuese e pastaj të ulët ose profesionale.

Neni 15

Zëvendës Drejtorët e Përgjithshëm

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës ka dy (2) zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm:

1.1. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Siguri-Operativë;

1.2. Zëvendës Drejtor i përgjithshëm për trajtim.

2. Procedura për përzgjedhjen e zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm bëhet përshtatshëm sipas kriterëve për emërimë në pozita të larta drejtuese.

3. Emërimi i zëvendës drejtorëve të përgjithshëm bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Procedura për përfundimin e marrëdhënies së punës nga pozita e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm bëhet përshtatshëm me dispozitat për përfundimin e marrëdhënies së punës nga pozita e Drejtorit të Përgjithshëm, autoriteti vendimmarrës është Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.
5. Me përfundimin e mandatit për Zëvendës drejtor të Përgjithshëm, njësia përgjegjëse detyrohet të emërojë nëpunësin të cilin i mbaron mandati në një pozitë të mesme drejtuese e pastaj të ulët ose profesionale.

Neni 16 **Njësia Ekonomike**

1. SHKK përmes njësisë përkatëse zhvillon aktivitete ekonomike, prodhuese, ofron shërbime, punëson të burgosurit dhe krijon të hyra për nevojat e SHKK-së me qëllim të risocializimit, plotësimin e nevojave të SHKK-së, uljen e kostos buxhetore të shpenzimeve.
2. Njësia ekonomike prodhon dhe përpunon produkte bujqësore dhe industriale nga punëtoritë e saj për nevojat e SHKK-së, produktet të cilat konsiderohen tepriçë i plasohen në treg.
3. Në bazë të aktiviteti ekonomik njësia krijon të hyra dhe këto të hyra i shfrytëzon për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
4. Të hyrat e realizuara nga aktiviteti ekonomik do të shpenzohen në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
5. Njësia Ekonomike, menaxhon me blerjet dhe shitjet, përgatit analiza për të hyrat nga institucionet përkatëse duke pasur për bazë kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si dhe veprimtarive prodhuese.
6. Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm mund të lidhë marrëveshje me operatorë të ndryshëm ekonomikë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
7. Struktura organizative e Njësisë Ekonomike rregullohet me aktin nënligjor për organizimin dhe sistematizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.
8. Ministri i Drejtësisë nxjerr akt nënligjor për funksionimin e kësaj njësie.

Neni 17 **Vlerësimi dhe Klasifikimi i të Burgosurve**

1. SHKK bënë vlerësimin individual të rrezikut dhe të nevojave për të gjithë të dënuarit përmes Njësisë për Vlerësim dhe Klasifikim.
2. Vlerësimi i sigurisë për të paraburgosur bëhet nga IK ku janë të pranuar të paraburgosurit.
3. Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit për të dënuarit të cilët janë pranuar në IK bënë rivlerësimin individual të rrezikut dhe të nevojave përmes mekanizmave të saj.
4. Pas procesit të vlerësimit hartohet plani individual për ekzekutimin e dënimit sipas specifikave të secilit të dënuar.
5. Drejtori i Përgjithshëm ose i autorizuari i tij me vendim përcakton vendosjen e personit të dënuar në IK ku do të zbatohet plani individual i trajtimit.

6. IK mund të kërkojnë nga Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të bëjë rivlerësimin e planit individual për shkak të nevojave të dënuarit dhe rrethanave tjera të reja të krijuara, pas rivlerësimit nëse i dënuari duhet të transferohet në një Institucion tjetër, Njësia e Vlerësimit dhe Klasifikimit i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të vendos për transfer.

7. Vlerësimi dhe klasifikimi i të burgosurve bëhet nga zyrtarët vlerësues të trajnuar.

8. Struktura organizative e Njesisë për Vlerësim dhe Klasifikim rregullohet me aktin nënligjor për organizimin dhe sistematizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës të nxjerr nga Qeveria e Kosovës.

9. Ministri i Drejtësisë nxjerr akt nënligjor për funksionimin e kësaj njësie.

Neni 18

Inteligjenca e Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes Njesisë së Inteligjencës bënë: planifikimin, mbledhjen, sistemimin, analizimin, shpërndarjen dhe mbrojtjen e informacionit të inteligjencës specifike që paraqesin kërcënim dhe rrezik për rendin dhe sigurinë e institucioneve korrektuese.

2. Në bazë të vlerësimit të informacionit Njësia për Inteligjencë paralajmëron Drejtorin e Përgjithshëm të SHKK-së dhe kërkon ndërmarrjen e masave me qëllim të parandalimit të kërcënimit të sigurisë ndaj SHKK-së dhe institucioneve korrektuese.

3. Inteligjenca e SHKK-së për të mbledhur informacion gjatë punës së saj do të zbatojë teknikat e specializuara të inteligjencës korrektuese, teknologjitë dhe praktikat më të mira të cilat janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

4. Njësia e inteligjencës së SHKK-së është përgjegjëse për identifikimin e individëve dhe grupeve që paraqesin kërcënim të sigurisë në institucionet korrektuese, informimin, shkëmbimin e informacioneve dhe inteligjencës me institucionet kompetente.

5. Inteligjenca e SHKK-së bashkëpunon me institucionet tjera kompetente me qëllim mbrojtjes së sigurisë së përgjithshme.

6. Struktura organizative e Njesisë së Inteligjencës rregullohet me aktin nënligjor për organizimin dhe sistematizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

7. Funksionimi i Njesisë së Inteligjencës bëhet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 19

Përcjellja e të Burgosurve

1. SHKK përmes Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve bënë zbatimin e urdhëresave dhe kërkesave të organeve kompetente për përcjelljen dhe shoqërimin e të burgosurve jashtë IK në:

- 1.1. Gjykata;
- 1.2. Prokurori;
- 1.3. Spitale;
- 1.4. Shikim të vendit të ngjarjes;
- 1.5. Transferime mes IK;
- 1.6. Përcjellje humanitare;
- 1.7. Përcjellje të tjera sipas nevojës.

2. Zyrtarët e NJPB-së janë përgjegjës për sigurinë e të burgosurve gjatë përcjelljes jashtë IK.
3. Zyrtarët e NJPB-së gjatë përcjelljes së të burgosurit janë të autorizuar të bartin armën zyrtare dhe pajisjet tjera të sigurisë sipas legjislacionit në fuqi.
4. Struktura organizative e NJPB rregullohet me aktin nënligjorë për organizimin dhe sistematizimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.
5. Funkcionimi i NJPB bëhet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 20

Trajtimi shëndetësor i Personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. Kujdesi shëndetësor për personelin e SHKK-së bëhet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Gjatë orarit të punës personeli i SHKK-së mund të marrë shërbime shëndetësore adekuate nga njësia shëndetësore e IK, duke përfshirë edhe shërbime diagnostikuese, farmaceutike, dhe të transportit deri në institucionin shëndetësor përkatës.
3. SHKK-ja është përgjegjëse për të krijuar kushte të punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës dhe të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndime në punë apo sëmundje profesionale sipas legjislacionit në fuqi.
4. SHKK është e detyruar t'iu sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në institucione shëndetësore licencuara për shërbime nga mjekësia e punës së paku një herë në tri (3) vite.

KAPITULLI III

INSTITUCIONET KORREKTUESE

Neni 21

Llojet e institucioneve korrektuese

1. Shërbimi Korrektues me qëllim të ekzekutimit të sanksioneve penale si: dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm, dënimin me burgim për të mitur, masën edukuese korrektuese për të mitur si dhe masën e paraburgimit, përbëhet nga këto Institucione Korrektuese:

1.1. Qendrat Korrektuese;

1.2. Qendrat e Paraburgimit;

1.3. Institucionet e Sigurisë së Lartë.

2. Në kuadër të një Institucioni Korrektues mund të ekzistojnë njësi të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur, varësisht nga nevojat e institucionit.

3. Brenda institucioneve korrektuese ekzistojnë edhe stacionar për trajtimin dhe ekzaminimin shëndetësor për të burgosur.

4. Në Qendrën korrektuese për femra ekziston objekti i posaçëm për trajtimin e të burgosurave shtatzëna dhe nënave me fëmije deri në moshën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, si dhe njësia për femra të mitura.

Neni 22

Tipet e Institucioneve Korrektuese

1. Në bazë të shkallës së sigurisë dhe mënyrës së trajtimit të burgosurve, institucionet korrektuese mund të jenë të tipit të mbyllur, gjysmë të hapur dhe të hapur.

2. Institucionet korrektuese të tipit të mbyllur kanë elemente maksimale të sigurisë fizike dhe materiale siç janë: muret e larta rrethuese apo rrethoja me staf të armatosur, pajisjet teknike dhe masat tjera të sigurisë.

3. Institucionet korrektuese të tipit gjysmë të hapur kanë elemente të mesme të sigurisë fizike dhe materiale.

4. Institucionet korrektuese të tipit të hapur kanë elemente të ulët sigurisë fizike dhe materiale. Sjellja e personave të dënuar bazohet në vetë disiplinën e tyre dhe përgjegjësinë personale kurse personeli korrektues mbikëqyrë lëvizjen dhe punën e personave të dënuar.

Neni 23

Themelimi, ndryshimi dhe shuarja e Institucionit Korrektues

Me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, ministri i Drejtësisë nxjerr akt nënligjor për themelimin, ndryshimin apo shuarjen e Institucionit Korrektues, me cilin akt përcaktohet lloji, tipi dhe selia e Institucionit Korrektues.

Neni 24

Përgjegjësitë e Institucioneve Korrektuese

1. Institucionet korrektuese bëjnë ekzekutimin e sanksioneve penale me burgim, burgimit të përjetshëm, masën e paraburgimit, dënimin me burg për të mitur dhe masën edukative korrektuese për të mitur sipas aktgjykimeve, aktvendimeve dhe urdhëresave të gjykatave kompetente.

2. Ndërmerr masa për të siguruar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm për të gjithë.

3. Ofron kushte të përshtatshme për jetesë për të burgosurit dhe kushte optimale për punë për personelin e SHKK-së.

4. Mundëson realizimin e të drejtave të burgosurve sipas legjislacionit në fuqi.

5. Miratimin, zhvillimin dhe implementimin e programeve për edukim dhe aftësim profesional si dhe programeve tjera për risocializimin dhe riedukimin e të burgosurve.

Neni 25

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit të Institucionit Korrektues

1. Drejtori i IK organizon, udhëheq, kontrollon veprimtarinë e përgjithshme të IK sipas legjislacionit në fuqi, udhëzimeve dhe urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së.

2. Siguron ligjshmërinë e pranimit dhe lirimit të burgosurit.

3. Ndërmerr masa për të ruajtur dhe garantuar një ambient të përshtatshëm për jetën e të burgosurve dhe zhvillimin e aktiviteteve në IK.

4. Është përgjegjës për planifikimin e ekzekutimit të dënimit.

5. Është përgjegjës për aktivitetin e IK në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe për trajtimin e barabartë të personave të burgosur.

6. Është përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e financave për IK.

7. Siguron kushte për punë për personelin e IK.

8. Koordinon, kontrollon dhe siguron zbatimin e detyrave dhe programeve të punës përmes mekanizmave të brendshëm.

9. Vendos për masat disiplinore ndaj të dënuarve.
10. Trajton dhe u përgjigjet ankesave dhe kërkesave të burgosurve në IK sipas kompetencës së tij.
11. I raporton Drejtorit të Përgjithshëm.
12. Kryen detyra dhe obligime tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Emërimi i Drejtorit të Institucionit Korrektues

Emërimi në pozitën e Drejtorit të IK bëhet përshtatshëm me procedurat e lëvizjes dhe ngritjes në detyrë sipas Ligjit për Zyrtarë Publikë.

Neni 27

Emërimi i zëvendës drejtorit të IK

1. Institucionet Korrektuese kanë nga një zëvendës drejtor, përjashtimisht institucionet e sigurisë së lartë dhe institucionet me veprimtari komplekse dhe me numër të madh të punësuarve dhe kapacitete të lartë të burgosurve mund t'i kenë deri në dy (2) zëvendës drejtorë.

2. Procedura për përzgjedhjen e zëvendës drejtorëve të IK bëhet përshtatshëm sipas kriterëve të parapara për pozitën drejtor i IK.

Neni 28

Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. Personelin e Shërbimit Korrektues të Kosovës e përbëjnë:

1.1. nëpunësit civil;

1.2. zyrtarët korrektues profesional të armatosur në uniformë dhe grada të rregulluara me këtë Ligj;

1.3. stafi mbështetës përbëhet nga stafi teknik dhe administrativ të cilët kryejnë veprimtari ndihmëse.

2. Personeli i SHKK sipas paragrafit 1. të këtij neni janë nëpunës civil dhe nëpunës të uniformuar të sigurisë, sipas këtij ligji dhe ligjit për zyrtarët publikë.

3. Personeli i Shërbimit Korrektues sipas paragrafit 1. të këtij neni janë nëpunës civil me status të veçantë sipas ligjit për zyrtarët publikë.

Neni 29

Të Drejtat e Personelit të SHKK-së

1. Përveç të Drejtave që janë të përcaktuara me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit të Punës, personeli i SHKK-së ka edhe këto të drejta dhe detyrime specifike:

1.1. e drejta e shtesës së rrezikshmërisë mbi pagë:

1.1.1. personeli i SHKK-së për shkak të ekspozimit ndaj rrezikut të lartë dhe të drejtpërdrejt me të burgosur me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë, dënim dhe dënim të përjetshëm, sëmundje infektive çrregullime mendore, ekspozimit rrezikut gjatë përcjelljes së të burgosurit jashtë institucionit korrektues, gëzon shtesë mbi page për rrezikshmëri në pune;

1.1.2. kategorizimi i personelit të SHKK-së që përfiton shtesë mbi pagë për rrezikshmëri do të rregullohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri i Drejtësisë.

1.2. e drejta e pagës jubilarë:

1.2.1. personeli i SHKK-së gëzon të drejtën e një page jubilarë për çdo dhjetë (10) vite përvojë pune të pandërprerë në vlerë të një page bazë.

1.3. e drejta në shtesë të një page bazë në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes;

1.4. e drejta e një shujte ditore:

1.4.1. personeli i SHKK-së gjatë kryerjes së detyrës zyrtare e gëzon të drejtën e një shujte ditore;

1.4.2. vlera e shujtës ditore përcaktohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm.

1.5. e drejta në kompensim për vdekje në detyrë apo në kryerje të detyrës.

1.5.1. SHKK paguan shpenzimet e ceremonisë së varrimit për personelin e SHKK-së që vdesë gjatë kryerjes së detyrës apo që ndërlihet me detyrën zyrtare. Vendvarrimi do të caktohet nga anëtarët e familjes.

2. SHKK do t'i paguajë shpenzimet në vijim:

2.1. transportin për bartjen e kufomës;

2.2. shpenzimet e udhëtimit për dy (2) persona shoqërues;

2.3. shpenzimet e funeralit që nuk janë paguar në forma të tjera;

2.4. shpenzimet e tjera me aprovimin e ministrit.

3. SHKK-ja do të kompensojë bashkëshortin apo bashkëshorten, fëmijët nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare të personelit të SHKK-së i cili vdes gjatë kryerjes së detyrës apo që ndërlihet me detyrën zyrtare me një ndihmë financiare të menjëhershme në një shumë që është e barabartë me pagën mujore bruto të shumëzuar me gjashtë(6). Në raste të caktuara sipas vlerësimit, Qeveria mund të ndaj shumë më të lartë financiare të menjëhershme për ta.

4. Personeli i SHKK-së gëzon të drejtën e tri (3) pagave bruto me rastin e pensionimit të rregullt.

Neni 30 Grevat dhe protestat

1. Personeli korrektues nuk ka të drejtë të bëjë grevë, por ka të drejtë t'i shprehë pakënaqësitë e tij nëpërmjet protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet përfaqësuese dhe sindikale, përderisa nuk rrezikohet funksionaliteti i SHKK-së.

2. Në rast të protestave, personelit korrektues të SHKK-së, i ndalohet që gjatë protestës të bartin armën zyrtare.

Neni 31 Konfidencialiteti i të dhënave

1. Personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës gjatë ushtrimit të detyrës janë të detyruar të ruajnë dhe trajtojnë informacionet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Personelit të SHKK-së i ndalohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të burgosurve si dhe të dhëna me karakter konfidencial.

3. Personeli SHKK-së janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 32 **Zbatimi i urdhrave**

1. Personeli i SHKK-së është i detyruar të zbatojë urdhrat e dhënë nga eprorët sipas shkallës funksionale dhe sipas hierarkisë së gradës. Urdhrat duhet të jepen në përputhje me detyrën funksionale si dhe të mos jenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

2. Në rast se zyrtari dyshon për ligjshmërinë e urdhrat të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin e paligjshmen por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e tij.

3. Zyrtari ka detyrim të zbatojë urdhrin e konfirmuar me shkrim sipas paragrafit 2. të këtij neni, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbënë vepër penale.

Neni 33 **Detyrimi për shmangien nga konflikti i interesit**

Personeli i SHKK-së duhet të mos lejojë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt interesi. Personeli i SHKK-së veprojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.

KAPITULLI IV **MARRËDHËNIA E PUNËS PËR ZYRTAR KORREKTUES KRITERET SHITESË DHE** **PROCEDURA E VEÇANTË**

Neni 34 **Themelimi i marrëdhënies së punës kadet për zyrtarë korrektues**

1. Themelimi i marrëdhënies së punës për pozitën kadet për zyrtar korrektues në Shërbimin Korrektues bëhet në pajtim me parimin e meritës, aftësisë profesionale, transparencës së procesit, paanshmërisë, integritetin, mos-diskriminimit, mundësive të barabarta dhe të drejtën për t'u ankuar.

2. Të drejtë konkurrimi dhe punësimi në pozitën kadet për zyrtar korrektues, kanë të gjithë personat të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara me konkursin publik, i cili bazohet në këtë Ligj dhe në Ligjin për Zyrtarët Publikë.

3. SHKK ofron mundësi të njëjta punësimi të gjithë personave të interesuar pa dallim përkatësie etnike, gjinie, ngjyre, religjioni, bindje politike, me kusht që ata t'i përmbushin kriteret e përcaktuara në konkursin e shpallur.

Neni 35 **Identifikimi, vlerësimi dhe planifikimi i vendeve të lira të punës**

1. Identifikimi i vendeve të lira të punës kadet për zyrtar korrektues si dhe vlerësimi i nevojave për vende të reja të punës bëhet nga institucionet korrektuese dhe kërkesa i dërgohet njësisë së burimeve njerëzore të SHKK-së.

2. Planifikimi periodik i nevojave për rekrutim bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e SHKK-së.

Neni 36

Procesi i rekrutimit

1. Procesi i rekrutimit zhvillohet nga Drejtoria e Përgjithshme e SHKK-së në pajtim me nevojat për kadet për zyrtar korrektues sipas planit të personelit dhe pas konfirmimit të disponueshmërisë së mjeteve buxhetore për pozitën përkatëse.
2. Pas plotësimit të kushteve nga paragrafi 1. i këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm merr vendim për shpalljen e konkursit.

Neni 37

Afati i procesit të rekrutimit

Afati i procesit të rekrutimit për pozitën kadet për zyrtar korrektues llogaritet nga shpallja e konkursit e deri në publikimin e listës përfundimtare të kandidatëve dhe nuk mund të zgjasë më shumë se katër (4) muaj.

Neni 38

Konkursi për punësim

1. Konkursi për punësim për pozitën kadet për zyrtar korrektues në Shërbimin Korrektues të Kosovës bëhet përmes shpalljes publike në platformën shtetërore të punësimit dhe në web faqen zyrtare të SHKK-së, jo më vonë se pesë (5) ditë pas vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe i njëjti shpallet në faqen zyrtare të SHKK në gjuhët zyrtare në pajtim me ligjin për gjuhët.
2. Shpallja e konkursit për punësim përmbajë të dhënat si në vijim:
 - 2.1. emri i institucionit;
 - 2.2. pozita dhe përshkrimi i vendit të punës si dhe numri i referencës;
 - 2.3. kriteret për aplikim-pjesëmarrje në procesin e rekrutimit;
 - 2.4. koeficienti\grada e pagës;
 - 2.5. kualifikimet e nevojshme arsimore;
 - 2.6. moshën;
 - 2.7. kohëzgjatjen e emërimit, si dhe kohëzgjatja e periudhës provuese;
 - 2.8. dokumentacioni i nevojshëm për aplikim;
 - 2.9. njoftime për testet të cilave do t'u nënshtrohet kandidati, si dhe broshura informuese për të gjitha fazat e testimit të kandidatëve;
 - 2.10. mënyrën, vendin dhe adresën e saktë ku merren dhe dorëzohen aplikacionet;
 - 2.11. datën e mbylljes së konkurrimit e cila duhet të jetë së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit;
 - 2.12. njoftimin për mos pranimin e aplikacioneve pas afatit si dhe njoftimin për refuzimin e aplikacionit në rast se janë të mangëta;
 - 2.13. konkursi publik përmban klauzolën "Shërbimi Korrektues i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitet në Kosovë";

2.14. vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të njoftohen përmes webfaqes zyrtare të SHKK-së.

Neni 39

Kushtet e veçanta për rekrutim për pozitën kadet për zyrtarë korrektues

1. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë korrektues përpos kushteve të përgjithshme të paraparë me Ligjin për zyrtarë publikë, duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte e veçanta si në vijim:

- 1.1. të jetë i moshës tetëmbëdhjetë (18) deri në arritjen e moshës tridhjetë (30) vjet;
- 1.2. të jete në gjendje të mirë psiko-fizike;
- 1.3. të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh në fytyrë, qafë apo duar;
- 1.4. të mos jetë nën hetime për vepër penale.

2. Dokumentacioni për aplikim duhet të përmbajë:

- 2.1. formularin e aplikimit;
- 2.2. kopjen e diplomës për arsimin e mesëm, përkatësisht të mesëm të lartë ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit, kopja e diplomës e nostifikuar;
- 2.3. CV-në;
- 2.4. vërtetimin nga organi kompetent që nuk është nën hetime;
- 2.5. kopjen e letërnjoftimit apo pasaportës.

Neni 40

Pranimi i aplikacioneve

1. Aplikacionet e kandidatëve prahen dhe regjistrohen nga Njësia e Burimeve Njerëzore.

2. Pas mbylljes së konkursit por jo me vonë se pesë (5) ditë pune, Njësia e Burimeve Njerëzore përgatitë listën e aplikantëve dhe të njëjtën së bashku me dosjet e kandidatëve ia dorëzon Kryesuesit të Komisionit përzgjedhës.

Neni 41

Komisioni përzgjedhës

1. Me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm emërohet Komisioni përzgjedhës, i cili përbëhet prej kryesuesit dhe katër (4) anëtarëve nga radhët e personelit të SHKK-së dhe siguron përfaqësim gjinor dhe etnik.

2. Anëtarët e Komisionit për rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve duhet të jenë punonjës me përvojë profesionale në fusha të ndryshme dhe kompetentë për të bërë vlerësimin e kandidatëve në fushat përkatëse.

3. Komisioni nga paragrafi 1. i këtij neni ka përgjegjësitë si në vijim:

- 3.1. shqyrtimin, vlerësimin e aplikacioneve si dhe hartimin e listës së kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret sipas konkursit;
- 3.2. përgatitjen, organizimin dhe vlerësimin testimeve sipas këtij neni;

3.3. shqyrtimin e kërkesave për rivlerësim të kandidatëve;

3.4. përgatitjen e raportit dhe listën përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm.

4. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e procedurës së rekrutimit.

Neni 42 **Procedura e testimit**

1. Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs, i nënshtrohen procedurave të testimit sipas radhitjes në vijim:

1.1. testi me shkrim;

1.2. testimi i shkathtësive fizike;

1.3. intervista me gojë, si dhe

1.4. testi shëndetësor.

2. Kandidati i cili dështon në njërin nga fazat e përzgjedhjes nuk ka të drejtë të vazhdojë në fazat tjera të procesit të rekrutimit.

Neni 43 **Testimi me shkrim**

1. Testi me shkrim përpilohet në gjuhët zyrtare dhe përbëhet nga pesëdhjetë (50) pyetje. Secila përgjigje e saktë ka vlerën e dy (2) poenëve dhe testi duhet të vlerësojë njohuritë në këto fusha:

1.1. katër dhjetë për qind (40%) njohuri të përgjithshme;

1.2. tridhjetë për qind (30%) njohuri për vendin e punës, si dhe

1.3. tridhjetë për qind (30 %) matematikë dhe gjuhë e letërsi.

2. Rezultati minimal i kërkuar për të kaluar me sukses testin është shtatëdhjetë (70) poenë të testit.

3. Koha e testimit zgjatë një (1) orë e tridhjetë (30) minuta.

Neni 44 **Testimi i shkathtësive fizike**

1. Standardet e testimit të shkathtësive fizike duhet të jenë të përshkruara në formularin, respektivisht në broshurën e shkathtësive fizike.

2. Gjatë procesit të testimit të shkathtësive fizike, përveç komisionit përzgjedhës duhet të jetë prezent edhe personeli mjekësor.

3. Nëse kandidati deklaron se është në gjendje të mirë shëndetësore dhe është i gatshëm t'i nënshtrohet testit të shkathtësive fizike, nga ai do të kërkohet që ta plotësojë dhe nënshkruajë formularin i cili SHKK-në e liron nga përgjegjësia dhe dëmshpërblimi, nëse atij gjatë këtij procesi i shkaktohet ndonjë problem shëndetësor apo lëndim fizik.

4. Vlerësimi i rezultatit të testit fizik bëhet në tri (3) elemente si: vrapim, pompa dhe barkore. Nëse kandidati nuk arrin të kalojë me sukses njërin nga këto elemente konsiderohet se ka dështuar.

Neni 45

Intervista me gojë

1. Me rastin e intervistimit me gojë, kandidati vlerësohet për mënyrën e paraqitjes dhe prezantimit, aftësisë komunikuese, njohurive të përgjithshme, aftësisë për të analizuar, vendimmarrja, motivimi, përkushtimi dhe vetëbesimi.
2. Kandidati duhet të arrijë së paku një rezultat prej gjashtëdhjetë (60) nga njëqind (100) poenët e mundshme për të vazhduar më tutje me procesin e rekrutimit.

Neni 46

Testimi shëndetësor

1. Testit shëndetësor do t'i nënshtrohen vetëm kandidatët të cilët kanë arritur poena maksimale sipas numrit të kërkuar për rekrutim.
2. Nëse njëri nga kandidatët nuk është në gjendje të mirë shëndetësore sipas raportit mjekësor, do të ftohen kandidatë sipas radhës me numrin më të madh të poenëve në listë, në rastet kur kandidatët sipas radhës kanë numër të barabartë të poenëve ftohet kandidati me emër sipas alfabetit.
3. Testi shëndetësor kryhet nga institucioni përkatës shëndetësor, i cili përfshinë por nuk kufizohet në:
 - 3.1. aftësitë dëgjimore;
 - 3.2. testet për shiqim (pranë, në distancë, ngjyra, periferike);
 - 3.3. ekzaminimi i mushkërive;
 - 3.4. forca (supe, qafë, shpinë, gishti);
 - 3.5. aftësitë motorike dhe sistemi nervor;
 - 3.6. ekzaminimi i lëkurës;
 - 3.7. ekzaminimi skeletor;
 - 3.8. gama e lëvizjes;
 - 3.9. kardiovaskulare (tre (3) minuta test i hapit);
 - 3.10. testi për vartësi nga droga.

4. Institucioni kompetent mjekësor lëshon raportin për gjendjen shëndetësore të kandidatit i cili është bazë për vendimmarrje të komisionit nëse kandidati kalon apo nuk kalon.

Neni 47

Rezultatet e kërkuara për emërim

Kandidati i suksesshëm konsiderohet ai i cili në testin me shkrim dhe intervistën me gojë ka arritur të grumbullojë me së shumti poenë por jo më pak se gjashtëdhjetë e pesë për qind (65 %) të maksimumit të pikëve të caktuara, me kusht të ketë kaluar testin e vlerësimit shëndetësor.

Neni 48

Raporti përfundimtar

Komisioni përzgjedhës i emëruar në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, pas përfundimit të gjitha procedurave të rekrutimit, përgatitë raportin dhe listën përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, me rekomandim për Drejtorin e Përgjithshëm.

Neni 49

Shpallja e rezultateve

1. Pas aprovimit të listës së kandidatëve nga Drejtori i Përgjithshëm, Njësia e Burimeve Njerëzore, në afat prej tri (3) ditëve shpallë rezultatet përfundimtare në webfaqe të internetit të SHKK.
2. Shpallja përmban të dhënat e kandidatëve si dhe pikët e fituara gjatë procesit të përzgjedhjes.

Neni 50

Kërkesa për rishqyrtim

1. Pas përfundimit të çdo faze të procesit të rekrutimit, Njësia e Burimeve Njerëzore në kuadër të SHKK-së, publikon listën preliminare të kandidatëve.
2. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të kërkojnë rishqyrtim të vlerësimit.
3. Kërkesa për rishqyrtim i drejtohet Komisionit përkatës përzgjedhës, në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e publikimit të listës preliminare.
4. Komisioni përzgjedhës shqyrton dhe vendos për kërkesën nga paragrafi 2. i këtij neni në afat prej pesë (5) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.
5. Pas vendimit të komisionit për kërkesat për rishqyrtim, Njësia e Burimeve Njerëzore publikon në webfaqen zyrtare të SHKK-së listën përfundimtare të kandidatëve të cilët kanë kaluar fazën përkatëse, së bashku me njoftimin për datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së testit të fazës pasuese.

Neni 51

E drejta në ankesë

Pas publikimit të listës përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, në afat prej tridhjetë (30) ditëve, kandidati i pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë ankesë tek organi kompetent.

Neni 52

Emërimi kadet për zyrtar korrektues

1. Pas konfirmimit nga Njësia e Burimeve Njerëzore për rregullsinë e procedurave të përcaktuara më këtë Ligj, kandidatët e suksesshëm ftohen për nënshkrimin e kontratës për punësim.
2. Kontrata nga paragrafi 1. i këtij neni nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së dhe nga i punësuari dhe përmban elementet e përcaktuara me legjislacionin përkatës të punës në fuqi.
3. Pas procedurës së rekrutimit, kadet e pranuar për zyrtarë korrektues i nënshtrohet trajnimit themelor në AKSP, kadeti emërohet zyrtar korrektues pas kalimit me sukses të gjitha moduleve të trajnimit dhe certifikimit.
4. Në rast se kadeti në AKSP edhe pas riprovimit nuk kalon ndonjërin nga modulet e trajnimit themelor atij i ndërpritet kontrata.
5. Kandidatët lidhin kontratë të punës me Shërbimin Korrektues, e cila përfshinë periudhën provuese një (1) vit.
6. Pas përfundimit me sukses të periudhës provuese, kontrata lidhet në bazë të dispozitave legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI V GRADAT E ZYRTARËVE KORREKTUES

Neni 53 Sistemi i Gradave

1. Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat vijuese:
 - 1.1. kadet për zyrtar korrektues;
 - 1.2. zyrtar korrektues;
 - 1.3. mbikëqyrës;
 - 1.4. mbikëqyrës i Lartë;
 - 1.5. udhëheqës i Njesisë.
2. Procedura dhe kushtet për gradim të zyrtarëve korrektues rregullohet me aktin e nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 54 Detyrat e Zyrtarit Korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës

1. Zyrtari Korrektues, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ka këto detyra primare:
 - 1.1. ofron siguri në institucionet korrektuese;
 - 1.2. merr masat e sigurisë për zhvillimin e veprimtarive të të burgosurve në institucionet korrektuese;
 - 1.3. zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të të burgosurve;
 - 1.4. merr masa për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave të burgosur;
 - 1.5. angazhohet në aktivitetet rehabilituese për të burgosur nëse ka shkathtësi dhe kualifikim përkatës;
 - 1.6. ndërmer veprime konkrete në parandalimin dhe zbulimin e kontrabandës dhe dukurive tjera negative;
 - 1.7. zbaton urdhërat e ligjshëm sipas zingjirit komandues;
 - 1.8. zbaton Kodin e Etikës Profesionale për zyrtarët korrektues;
 - 1.9. ruan dhe mirëmban pronën e IK-së;
 - 1.10. kryen edhe detyra shtesë sipas përshkrimit të detyrave të vendit të punës.

Neni 55 Aftësimi profesional

1. Zyrtarët korrektues pas çdo emërimi në gradë, duhet të ndjekë trajnimin vazhdues të rritjes së aftësive profesionale për gradën përkatëse.
2. Zyrtarët korrektues të cilët punojnë me grupe të veçanta të të burgosurve, si: të miturit, personat me aftësi të kufizuara, persona me nevoja të veçanta, etj., duhet të kryejnë trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse.

3. Personeli korrektues kanë të drejtën të përmirësojnë aftësitë profesionale për vendin e punës nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike, nga donatorë të huaj apo nga të ardhurat vetanake.

Neni 56 **Transferimi i zyrtareve korrektues**

1. Zyrtari korrektues mund të transferohet nga një institucion korrektues në tjetrin si:

1.1. transfer i përkohshëm;

1.2. transfer i përhershëm.

2. Transferimi i përkohshëm bëhet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm për nevojat e Institucioneve Korrekte apo me kërkesën e zyrtarit korrektues deri në gjashtë (6) muaj brenda dy (2) viteve.

3. Transferimi i përhershëm bëhet me kërkesë të zyrtarit korrektues dhe rekomandimin e drejtorit të institucionit dhe me vendim të drejtorit të përgjithshëm.

4. Transferi i përhershëm bëhet edhe në rastet e riorganizimit të brendshëm të punës ose mbylljes së një institucioni korrektues.

5. Zyrtari korrektues me kërkesën e tij mund të transferohet në pozitën e zyrtarit civil nëse i plotëson kriteret e parapara për pozitën, me rekomandimit të Drejtorit të IK dhe aprovim të Drejtorit të Përgjithshëm.

6. Zyrtari civil në SHKK me kërkesën e tij mund të transferohet në pozitën e zyrtarit korrektues në gradën ekuivalente me kusht që të ketë të përfunduar trajnimin për zyrtar korrektues.

7. Kur transferi i personelit korrektues të SHKK-së bëhet me kërkesë të institucionit korrektues, institucioni i mbulon shpenzimet e transportit.

Neni 57 **Kontrollimi mjekësor i zyrtareve korrektues**

1. Kontrollimi mjekësor për zyrtaret korrektues kryhet njëherë gjatë tri (3) viteve nga organi kompetent mjekësor i cili vërteton aftësitë psiko-fizike dhe shëndetësore, ndërsa sipas nevojës me propozimit të drejtorit të IK zyrtari mund të dërgohet për kontrolle mjekësore edhe në periudhat më të shkurta kohore për të cilën vendosë drejtori i përgjithshëm.

2. Nëse të i punësuarit nga paragrafi 1. i këtij neni paraqiten ndryshime psikike, apo në gjendjen e përgjithshme shëndetësore e cila e bënë të paaftë për kryerjen e atyre punëve udhëzohet në organin kompetent për vlerësimin e aftësisë punuese në pajtim me ligjin me të cilin përcaktohen të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor.

3. Në qoftë se organi kompetent përcakton ekzistimin e aftësisë profesionale të mbetur, i punësuarit sistemohet në punë të tjera në pajtim me mundësitë e shërbimit korrektues, apo i mundësohet rikualifikimi.

KAPITULLI VI **SHKELJET, PROCEDURA DHE MASAT DISIPLINORE**

Neni 58 **Shkeljet e posaçme disiplinore**

1. Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publikë, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta.

2. Shkelje të lehta disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen:

- 2.1. është i pasjellshëm apo fyes në fjalë apo në vepra, ndaj të burgosurve, punonjësve tjerë dhe publikut, gjatë detyrës apo në rrethana që kanë të bëjnë me detyrat e tij;
- 2.2. angazhohet në aktivitete politike që ndikojnë negativisht në kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të paanshme;
- 2.3. angazhon jashtë procedurës një të burgosur për të kryer ndonjë punë apo për të ofruar ndonjë shërbim pa marrë lejen nga mbikëqyrësi i tij;
- 2.4. mosmbajtja në mënyrë të rregullt të shkresave dhe të dhënave zyrtare që kanë lidhje me vendin e punës;
- 2.5. largim nga vendi i punës pa autorizim;
- 2.6. dy (2) mungesa të pa arsyeshme brenda vitit.

3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen:

- 3.1. vjedhja, mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve zyrtare;
- 3.2. dëmtimi i pronës;
- 3.3. ardhja në punë nën ndikimin e alkoolit apo të substancave narkotike, ose përdorimi i tyre gjatë orarit të punës;
- 3.4. shkeljet serioze e rregullave të sigurisë;
- 3.5. zbulimi i të dhënave apo informatave koifidenciale;
- 3.6. jep deklarata publike për Shërbimin Korrektues, pa autorizim të Drejtorit Përgjithshëm;
- 3.7. shfrytëzon në mënyrë të palejuar titullin apo autoritetin e tij për përfitim personal;
- 3.8. jep informata për të burgosurit pa autorizim;
- 3.9. ngacmimit seksual i ndonjë të burgosuri, të punësuarit apo vizitorit;
- 3.10. diskriminimi në çfarëdo forme ose keqtrajtimi i drejtpërdrejtë ose tërthorazi kundër të burgosurve, zyrtarëve ose të punësuarve tjerë;
- 3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues;
- 3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës;
- 3.13. me vetëdije apo me pakujdesi lëshon ose nënshkruan deklaratë të rremë në lidhje me përmbushjen e detyrës;
- 3.14. duke qenë përgjegjës, apo person me autoritet, injoron apo nuk ndërmerret masa kur një punonjës shkelë rregullat dhe detyrat e punës;
- 3.15. nuk i raporton autoritetet më të larta mbi çdo mall kontrabandë që zbulon tek ndonjë punonjës, i burgosur apo anëtar tjetër të publikut;

- 3.16. nga pakujdesia rrezikon ose shkakton dëme fizike apo vdekjen e ndonjë te burgosurit punonjësi tjetër të Shërbimit apo personi tjetër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi;
- 3.17. përdorë forcën e cila nuk është e kufizuar në intensitetin dhe zgjatjen e saj deri në atë masë që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim;
- 3.18. përdorë mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e Shërbimit Korrektues;
- 3.19. lejon ose mundëson arratisjen e ndonjë të burgosuri;
- 3.20. nuk ndërmerri masat e duhura, që ka, kur ndonjë i burgosur shkelë rregulla e brendshme, sulmon një punëtor, të burgosur tjetër, ose anëtarë të publikut;
- 3.21. nuk jep llogari, mban pa vend, dhe keqpërdorë të hollat e pronën e publikut apo të hollat/pronën e çdo personi tjetër që i bien në dorë gjatë kryerjes së detyrës së tij;
- 3.22. flenë gjatë orarit të punës;
- 3.23. detyron, nxit apo përpiqet që me çdo kusht të detyrojë një punonjës tjetër të marrë pjesë në punë ilegale apo të palejuar, apo në shkeljen e standardeve të etikës profesionale;
- 3.24. nuk bën raportimin të menjëhershëm të një incidenti në institucion; Përleshet me punëtorët tjerë të Shërbimit apo ndonjë anëtar tjetër të publikut gjatë detyrës;
- 3.25. fut apo nxjerr nga burgu kontrabandë apo sende të pa lejuara;
- 3.26. nuk raporton te zyrtarët kompetent, rastet e keqtrajtimit të të burgosurve nga ana e punëtorëve tjerë;
- 3.27. nuk raporton dhe nuk merr masa ndaj shkeljeve nga të burgosurit, konform dispozitave ligjore;
- 3.28. fsheh, mban, injoron, dëmton apo asgjëson ndonjë ankesë apo raport të bërë kundër ndonjë zyrtari ose te burgosuri;
- 3.29. keqpërdorimi i armës zyrtare apo humbja e saj.

Neni 59 **Masat disiplinore**

1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj personelit SHKK-së, janë:
 - 1.1. vërejtje;
 - 1.2. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në katër dhjetë për qind (40%) e pagës për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj;
 - 1.3. transferimi në institucion tjetër korrektues deri në gjashtë (6) muaj;
 - 1.4. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy(2) deri në pesë (5) vjet;
 - 1.5. ulje në pozitë;

1.6. largimi nga shërbimi civil.

2. Procedura disiplinore zhvillohet ne pajtim me ligjin për zyrtarët publikë.
3. Procedura dhe shqiptimi i masave disiplinore rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 60 **Përdorimi i forcës**

1. Zyrtari korrektues përdorë forcën vetëm kur ajo është e domosdoshme për parandalim të:
 - 1.1. arratisjes;
 - 1.2. sulmit fizik ndaj personelit të SHKK-së apo ndonjë personit tjetër;
 - 1.3. vetëlëndimit;
 - 1.4. shkaktimit të dëmeve materiale;
 - 1.5. rezistencës aktive, apo pasive gjatë ekzekutimit të urdhrave ligjorë nga zyrtari korrektues.
2. Forca e përdorur duhet të jetë në masë sa më të vogël dhe proporcionale me rrezikun.
3. Forca mund të përdoret vetëm kur ajo lejohet nga drejtori i institucionit korrektues, përveç nëse zyrtari korrektues me arsye vlerëson se drejtori do ta lejonte përdorimin e forcës dhe se vonesa e marrjes së lejes do të rezultonte në mosarritjen e qëllimit.
4. Nëse forca është përdorur pa leje në pajtim me paragrafin 3. të këtij neni, zyrtari korrektues e njofton drejtorin e institucionit korrektues për veprimin e ndërmarrë sa më parë që të jetë e mundur.
5. Kur përdoret forca, i burgosuri ndaj të cilit është përdorë forca menjëherë i nënshtrohet kontrollit mjekësor dhe trajtimit të rekomanduar përkatës.
6. Zyrtari korrektues gjatë kryerjes së detyrës zyrtare mund të përdor forcë edhe ndaj personave tjerë brenda dhe jashtë hapësirave të IK të cilët rrezikojnë sigurinë, apo nuk i binden urdhrave të tyre.
7. Pas përdorimit të forcës pa vonesë përpilohet raporti për arsyen e përdorimit të forcë.

Neni 61 **Mjetet kufizuese dhe pajisjet e sigurisë**

1. Zyrtari korrektues gjatë kryerjes së detyrës zyrtare bartë dhe mund të përdorë mjetet kufizuese dhe pajisjet e sigurisë të autorizuar nga SHKK.
2. Mjetet kufizuese dhe pajisjet e sigurisë duhet të përdoren për kohë sa më të shkurtë të mundshme.
3. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimeve apo dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese në rastin e përdorimit të mjeteve kufizuese dhe pajisjeve tjera të sigurisë.
4. Pas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë me vendim përcakton Listën e mjeteve kufizuese dhe pajisjeve tjera të sigurisë.

Neni 62**Mbajtja dhe përdorimi i armëve të zjarrit**

1. Zyrtari korrektues gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj ka të drejtë të mbajë armë dhe pajisje tjera të sigurisë vetëm në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara në legjislacioni në fuqi.
2. Shërbimi Korrektues aftëson dhe certifikon zyrtarë korrektues për përdorimin e armës dhe pajisjeve tjera të sigurisë.
3. Përveç zyrtarit korrektues me armë mund të pajisen edhe zyrtarët tjerë me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm, në bazë të rekomandimit nga Departamenti i Sigurisë.
4. Leja për mbajtjen e armës së zjarrit epet nga Institucioni kompetent.
5. Arma mund të mbahet edhe jashtë orarit të punës brenda territorit të Republikës së Kosovës.
6. Zyrtarët korrektues përveç armës personale zyrtare mund të ngarkohet edhe me armë tjerët e cila është e lejuar për përdorim nga SHKK gjatë orarit të punës.
7. Zyrtari korrektues dhe stafi tjetër armët personale nuk do t'i mbajnë brenda zonës së banimit në IK, përveç nëse kërkohet ndryshe për sigurinë e institucionit korrektues.
8. Arma e zjarrit mund të përdoret si mjet i fundit kur siguria e institucionit korrektues, apo siguria e personave rrezikohet seriozisht nga brenda dhe jashtë institucionit korrektues.
9. Përdorimi i armëve të zjarrit i paraprinë një paralajmërim se do të përdoret arma e zjarrit ose nga një e shtënë paralajmëruese.
10. Përdorimi i armëve të zjarrit pa një paralajmërim paraprak ose e shtënë paralajmëruese, lejohet në rast urgjent për të parandaluar rrezikun e pa shmangshëm dhe të drejtpërdrejt për jetën.
11. Zyrtari korrektues mund të përdorë armën për mbrojtjen e jetës personale vetëm nëse vlerëson se sulmi është i pashmangshëm dhe jeta e tij i është rrezikuar drejtpërdrejtë.
12. Përdorimi i armës së zjarrit duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë.
13. Shërbimi Korrektues siguron hapësira të sigurta në IK për ruajtjen e armëve të zjarrit dhe municionit.
14. Personit ndaj të cilit është përdorë arma e zjarrit, sa më parë që të jetë e mundur duhet t'i ofrohet ndihma mjekësore.
15. Përdorimi i armëve të zjarrit raportohet me shkrim te Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues.
16. Drejtori i Përgjithshëm me rregulla të brendshme përcakton procedurën e dhënies dhe marrjes së lejes, ruajtjes së armëve dhe municionit.

Neni 63**Vizitat e personave apo grupeve në institucionet korrektuese**

1. Drejtori i Përgjithshëm në bazë të kërkesës lejon vizitat e personave, grupeve të interesuara, përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe të huaja, si dhe të shoqatave të cilat merren me mbrojtjen e drejtave njerëzore, të punëtorëve shkencor të cilët merren me hulumtimin e kriminalitetit, përfaqësuesve të mjeteve të informimit si dhe të studentëve të fakulteteve përkatëse në institucionet korrektuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni nuk zbatohen në raport me përfaqësuesit e organeve shtetërore kur kryejnë punët nga kompetenca e tyre.

3. Personave të cilët vizitojnë institucionin korrektues, Drejtori i Përgjithshëm mund të lejojë bisedë me personat e dënuar, apo me personat e caktuar të dënuar, me prezencën apo pa prezencën personit zyrtar. Ky paragraf nuk cenon autorizimet e Avokatit të Popullit.

Neni 64 **Publiciteti i punës**

1. Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së, drejtpërdrejt apo nëpërmjet personave të cilët i autorizojnë, e informojnë opinionin për ekzekutimin e sanksioneve penale, për punën dhe proceset në SHKK, me kusht që të mos shkelet sekreti zyrtar dhe të mos rrezikohet siguria në institucionin korrektues.

2. Të gjitha informacionet lidhur me personat e dënuar dhe të paraburgosurit janë konfidenciale, nuk zbulohen dhe nuk bëhen të njohura për opinionin apo për mediat.

3. Përrjashtimisht nga paragrafi 2. i këtij neni, Ministri apo Drejtori i Përgjithshëm mund t'i bëjë të njohura informacionet konfidenciale për mediat, ose grupet tjera të informimit publik nëse dhënia e këtyre informacioneve është në pajtim me interesin e përgjithshëm publik.

4. Personat e dënuar nuk mund të intervistohen nga mediat apo personat tjerë pa pëlqim paraprak të tij dhe pa lejen e Drejtorit të Përgjithshëm.

5. Për të mitur zbatohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të mitur.

6. Drejtori i Përgjithshëm sipas marrëveshjes së lidhur, iu lejon qasje në dokumente organizatave të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

7. Dispozitat e këtij neni nuk e cenojnë autorizimin që e ka Avokati i Popullit apo Institucionet tjera të autorizuar sipas ligjeve në fuqi.

Neni 65 **Medaljet, lëvdatat dhe mirënjohjet**

1. Kryeministri, Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm janë të autorizuar t'u japin medalje, lëvdata, shpërblime dhe mirënjohje, zyrtarëve korrektues, punëtorëve të tjerë të SHKK-së, personave fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj që e kanë dalluar vetën me meritat e tyre.

2. Kryeministri jep medaljen në vijim:

2.1. medaljen e nderit.

3. Ministri jep medaljet në vijim:

3.1. medaljen për merita;

3.2. medaljen për trimëri, si dhe

3.3. medaljen e shpëtimit të jetës.

4. Drejtori i Përgjithshëm jep medaljet në vijim:

4.1. medaljen për shërbim të dalluar;

4.2. medaljen korrektuese për lëvdim, si dhe

4.3. medaljen për shërbim të besnikërisë.

5. Mirënjohje dhe lëvdata jep Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori i IK-së.
6. Procedura e dhënies së medaljeve, lëvdatave dhe mirënjohjeve të parapara me paragrafin 4. të këtij neni përcaktohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 66
Mbikëqyrja për Shërbimin Korrektues të Kosovës

Mbikëqyrjen për SHKK e bëjnë institucionet kompetente të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI VII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 67
Mandati i Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve të IK

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji Drejtorët dhe Zëvendës drejtorë e IK vazhdojnë të ushtrjnë detyrën deri në përfundimin e mandatit ekzistues.
2. Me rastin e përfundimit të mandatit ekzistues, kandidati i cili nuk rizgjedhet në pozitën e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të IK, duhet të sistemohet në një pozitë të nivelit të ulët drejtuese apo në një pozitë profesionale.

Neni 68
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore sipas këtij Ligji zbatohen aktet nënligjore në fuqi, me kusht që mos të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji.

Neni 69
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-131
14 korrik 2022

Shpallur me dekretin Nr. DL-252/2022, datë 01.08.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu